



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 88 datë 27.09.2018

Për një shtesë në Vendimin Nr.17 datë 14.02.2017 të Këshillit të Bashkisë Skrapar “Për miratimin e numrit të linjave , përcaktimin e orareve , vendi i nisjes e vendi i mbërritjes, si dhe vlerën e biletës së udhëtimit, në linjën rrethqytetase të transportit të udhëtarëve në Bashkinë Skrapar”.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit Nr. 10/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa” në ligjin nr.8308. datë 18.08.1998 “Për transportin rrugor“, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5627, datë 18/11/2016 të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës” Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për leshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vëndit”.Këshilli i Bashkisë pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga grupi i punës me përfaqësues nga Drejtoria Juridike,Drejtoria e Shërbimeve ,Tatim taksave për problemin e transportit .

**V E N D O S I :**

- Të miratojë një linjë shtesë për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetase midis fshatrave të Njësisë Administrative Qendër me Qendrën e Qytetit të Çorovodës.

**1-Linja STORË – ÇOROVODË**

a - Vendi i qëndrimit për këtë itinerar do të jetë qendra e fshatit Storë dhe vendi i mbërritjes tek ish- agjensia e vjetër .

b – Përcaktimi i orarit të lëvizjes së mjeteve sipas linjave.

NR	LINJAT	NISJA		KTHIMI	
		NISJA	MBËRRITJA	NISJA	MBËRRITJA
1	Storë	6.30	7.30	13.30	14.30

C- Përcaktimi i vlerës së biletës së udhëtimit.



NR	LINJAT	GJATËSIA RRUGËS/ km	VLERA BILETES/LEK
1	Storë	11	150

Vendimi u miratua me 10 vota pro, — vota abstenim, — vota kundër.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**PARTIZAN GORÇE**

